



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 11.08.2017

Ref.: 7061/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa nr.584/17, datë 21.07.2017 e BPrAL Kolegji "Universum" për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së nr.571/17, datë 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit te akreditimit sipas vendimit nr.571/17, datë 06.07.2017 për programet e studimit të BPrAL Kolegji Universum, Kampusi në Prishtinë:
 - Menaxhment, MA, 120 ECTS, dhe
 - Shkenca Politike, BA, 180 ECTS.
- III. Hiqet masa e pezullimit te akreditimit sipas vendimit nr.571/17, datë 06.07.2017 për programin e studimit të BPrAL Kolegji Universum, dega në Ferizaj:
 - Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS
- IV. Lejohet regjistrimi i studentëve në programin e studimit në programet e cekura në pikën dy dhe tre të këtij vendimi.
- V. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së nr.571/17, datë 06.07.2017 mbetet e pa ndryshuar.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Universum" me 21.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 571/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim BPrAL Kolegji "Universum" i është pezulluar akreditimi për programin e studimit: Kampusi në Prishtinë: Menaxhment, MA, 120 ECTS, dhe Shkenca Politike, BA, 180 ECTS. Dega në Gjakovë: Biznes dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS, dhe dega në Ferizaj: Biznes dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS, dhe Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL "Universum", është konstatuar që programet e cekura në pikën dy dhe tre të këtij vendimi, akreditimi i të cilit është pezulluar me vendim të KSHC-së nr.571/17, datë 06.07.2017, tani i plotësojnë kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2.

Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimi të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Universum";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

